



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Dega në Prizren

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR PYETËSORËT E REALIZUAR ME PALËT E JASHTME TË INTERESIT

Zyra për Sigurim të Cilësisë

Institucioni: Kolegji BIZNESI, Dega Prizren

Viti akademik: 2023-2024

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Hyrja.....	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë.....	5
1. Gjetjet.....	6
2. Realizimi Pytesorit.....	6
3. Analiza Përmbledhëse e Rezultateve të Vlerësimit.....	11
Rekomandimet.....	12

Lista e shkurtesave

IAL: Institucion i Arsimit të Lartë

KSCV: Komisioni për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit

KB: Kolegji Biznesi

ZSC: Zyra për Sigurim të Cilësisë

Hyrje

Kolegji Biznesi, si Institucion i Arsimit të Lartë i themeluar në vitin 2004, në mënyrë të vazhdueshme ka ndërmarrë veprime konkrete për ta bërë të matshëm dhe të dokumentueshëm procesin e sigurimit të cilësisë, duke përfshirë edhe bashkëpunimin sistematik me partnerët e industrisë. Në këtë kuadër, përveç pyetësorëve të rregullt me studentët dhe stafin akademik, Kolegji Biznesi realizon edhe pyetësorë të posaçëm me përfaqësues të industrisë dhe tregut të punës, me qëllim të vlerësimit të relevancës së programeve studimore, kompetencave të të diplomuarve dhe nivelit të bashkëpunimit institucion–industri.

Pyetësori me industrinë është hartuar për të reflektuar perceptimet dhe vlerësimet e akterëve ekonomikë lidhur me përputhshmërinë e programeve studimore me nevojat reale të tregut të punës, aftësitë profesionale dhe praktike të studentëve dhe të diplomuarve, si dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në fusha të tilla si praktikat profesionale, ligjëratat nga ekspertë të industrisë, projektet e përbashkëta dhe punësimi i të diplomuarve.

Kolegji Biznesi disponon mekanizma të qartë dhe funksionale për matjen dhe monitorimin e cilësisë, ku procesi mbikëqyret dhe analizohet në mënyrë të vazhdueshme nga menaxhmenti i institucionit, përfshirë Dekanin, Prodekanët, Përgjegjësit e Programeve Studimore dhe Koordinatorët për Cilësi, Zyra për Sigurim të Cilësisë në Kolegjin Biznesi, Prishtinë, ka rol kyç në organizimin, administrimin dhe analizimin e këtij procesi dhe përbën organin kryesor institucional për sigurimin e cilësisë së brendshme.

I gjithë procesi i hartimit të pyetësorit, shpërndarjes së tij dhe mbledhjes së të dhënave është realizuar nga Zyra për Sigurim të Cilësisë, në koordinim të plotë me strukturat përkatëse institucionale. Procesi është zhvilluar në mënyrë transparente dhe konfidenciale, duke garantuar anonimitetin e respondentëve nga industria dhe duke respektuar standardet etike dhe profesionale të bashkëpunimit institucional.

Me qëllim të ruajtjes së etikës profesionale, konfidencialitetit të respondentëve dhe prestigjit të institucionit, në këtë raport paraqiten vetëm gjetjet kryesore dhe përmbledhëse të pyetësorit. Rekomandimet, si pjesë përmbyllëse e raportit, përfshijnë sugjerime dhe vërejtje të rëndësishme të dhëna nga përfaqësuesit e industrisë, të cilat shërbejnë si bazë për përmirësime të mëtejshme strategjike dhe nuk publikohen në mënyrë të detajuar.

Zyra për Sigurim të Cilësisë

Zyra për Sigurim të Cilësisë është njësi funksionale e pavarur që vepron brenda strukturës institucionale të Kolegjit Biznesi, dhe raporton drejtpërdrejt te organet drejtuese të institucionit, në përputhje me aktet e brendshme dhe rregulloret në fuqi. Zyra për Sigurim të Cilësisë angazhohet në rritjen e vazhdueshme të cilësisë akademike dhe institucionale në Kolegjin Biznesi, duke zbatuar politikat e miratuara institucionale dhe instrumentet për matjen e cilësisë, të aprovuara nga Komisioni për Sigurim të Cilësisë (KSC).

Zyrtarët e cilësisë veprojnë në mënyrë të pavarur nga stafi akademik dhe nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies, duke garantuar objektivitet dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit. Zyra realizon matjen e cilësisë duke përdorur instrumentet standarde të

përfshira në paketën institucionale të instrumenteve për sigurim të cilësisë, të miratuara nga KSC.

Zyra për Sigurim të Cilësisë harton raporte analitike që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor apo proces vlerësimi të realizuar, të cilat i adresohen menaxhmentit të institucionit dhe organeve përkatëse vendimmarrëse. Po ashtu, gjetjet dhe rekomandimet i dërgohen përgjegjësve të programeve studimore dhe njësive akademike, me qëllim të planifikimit të zhvillimit profesional të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve studimore.

Realizimi i pyetësorit

Pyetësori me palët e jashtme të interesit është një pyetësorë që realizohet një herë në vit në kordinim me të gjitha njësive akademike përmes kordinatorëve për cilësi në kuadër të programeve studimore. Ky instrument shërben për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit institucional me industrinë dhe për të siguruar feedback të drejtpërdrejtë nga tregu i punës lidhur me cilësinë dhe relevancën e programeve studimore.

Procesi i realizimit ka qenë anonim dhe konfidencial, ndërsa të dhënat janë mbledhur, administruar dhe ruajtur nga **Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC)**.

Palët e jashtme të interesit kanë marrë pjesë në pyetësor përmes një pyetësori online (ink elektronik, i cili ka qenë i integruar me sistemin institucional të Kolegjit. Pyetësori ka përfshirë gjithsej 12 pyetje, 8 pyetje të mbyllura dhe 4 pyetje të hapura, të cilat kanë synuar vlerësimin e aspekteve kryesore të bashkëpunimit ndërmjet Kolegjin Biznesi dhe industrisë, si dhe përshtatshmërinë e aftësive dhe kompetencave të studentëve me kërkesat e tregut të punës.

Në mënyrë të veçantë, pyetjet kanë pasur për qëllim vlerësimin e këtyre elementeve kryesore:

- punësimi dhe angazhimi profesional i studentëve dhe të diplomuarve;
- përgatitja e studentëve për karrierë dhe tregun e punës;
- aftësitë dhe shkathtësitë profesionale të fituara gjatë studimeve;
- nevoja për lëndë të reja dhe programe studimore të përshtatura me zhvillimet e tregut;
- niveli i bashkëpunimit institucional me Kolegjin Biznesi;
- fushat potenciale të bashkëpunimit me industrinë;
- sugjerimet dhe komentet për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe programeve studimore.

Gjetjet e Pyetësorit


Pyetësori me palët e jashtme të interesit është realizuar përmes pytesorve online, në kordinim me njësitë akademike të Kolegjit Biznesi. Procesi ka gjeneruar komente dhe sugjerime të vlefshme, duke reflektuar interesim për bashkëpunim të mëtejshëm me institucionin.

Në pyetësor kanë marrë pjesë institucione publike dhe private, kryesisht biznese me përvojë shumëvjeçare në treg. Gjetjet tregojnë se palët e jashtme vlerësojnë pozitivisht misionin e Kolegjit Biznesi dhe përgatitjen profesionale të studentëve. Një pjesë e konsiderueshme e respondentëve kanë deklaruar punësim të të diplomuarve nga Kolegji Biznesi dhe nivel të kënaqshëm performance në punë.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë nivel të lartë kënaqshmërie dhe konfirmojnë rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit Biznesi dhe industrisë.


1. Lloji i Institucionit

■ Institucione shtetore ■ Ndërmarrje Publike ■ Institucion i arsimit
■ OJQ ■ Biznes



2. Lokacioni i Institucionit / Regjioni

■ Prishtinë ■ Gjilan ■ Ferizaj ■ Prizren ■ Pejë ■ Mitrovic ■ Gjakov



3. Cilat janë disa nga lehtësimet që keni nga bashkëpunimi me Kolegjin Biznesi?

- Praktikat e studentëve
- Bashkëpunimi profesional me stafin
- Hulumtimet shkencore
- Përgatitja e kuadrove të reja dhe profesionale
- Ngritja e kapaciteteve
- Shkëmbimi i përvojave
- Krijimi i pavarësisë profesionale
- Diplomë e njohur ndërkombëtarisht
- Shkëmbim të informacioneve

8. Cilat janë disa nga vështirësitë që hasni në bashkëpunimet me Kolegjin Biznesi?


- Aspektet financiare për projektet e përbashkëta
- Hulumtimet për nevoja të bizneseve nga instituti hulumtues
- Vizitat e ndërsjella (jo të shpeshta)

5. Në cilat fusha mund të zgjerojmë bashkëpunimin?

- Fusha e emërgjencave
- Hartime të planeve të biznesit
- Analiza të raporteve financiare
- Praktikat e studentëve
- Punësimi i studentëve
- Fusha e hulumtimeve shkencore


6. A keni të punësuar studentë që janë diplomuar në Kolegjin Biznesi

Po Jo




7. Sa jeni/keni qenë të kënaqur me punën e tyre?

Shumë i pakënaqur I pakënaqur I kënaqur Shumë i kënaqur




8. Programet studimore të Kolegjit Biznesi sa i plotësojnë kërkesat e juaja

Shumë i pakënaqur I pakënaqur I kënaqur Shumë i kënaqur




9. Sa ka nevojë për ndryshim të Programeve studimore në Kolegjin Biznesi

■ Nuk ka nevojë ■ Pjesërishtë ■ Plotësishtë



10. A ka ndonjë program të studimit/lëndë të re që ju do të na propozonit ta vendosim në planprogramet e ardhshme të Kolegjit Biznesi

■ Po ■ Jo




11. Nëse po specifikoj Programin/lëndën?

BA-Banka dhe Financa ne Biznes

12. Përshtypjet tuaja për Kolegjin Biznesi si Institucion i Arsimit të Lartë

■ Shumë i pakënaqur ■ Pak të kënaqur ■ Shumë të kënaqur ■ Të kënaqur



Rekomandimet

Zyra për Sigurimin e Cilësisë e dega Prizren e Kolegjit Biznesi, pas shqyrtimit të përgjigjeve të palëve të jashtme të interesit dhe duke u bazuar në fazën aktuale të zhvillimit institucional, rekomandon që të vazhdohet dhe të intensifikohen veprimet në drejtim të këtyre hapave:

- **Të zhvillohet një qasje e qëndrueshme institucionale për ndërkombëtarizim**, duke planifikuar dhe koordinuar në mënyrë të centralizuar mobilitetet akademike, aktivitetet e përbashkëta dhe projektet ndërkombëtare, me synim rritjen e përfshirjes së stafit dhe studentëve në iniciativa bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare.
- **Të rritet ndikimi i bashkëpunimit me palë të jashtme**, përmes përmirësimit të mekanizmave institucionale për menaxhimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke siguruar që këto partneritete të kontribuojnë në mënyrë të matshme në praktikën profesionale, punësimin e studentëve dhe zhvillimin e kompetencave të tyre.